Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0005

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Isa Hasani dhe Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së (OE) "Nika Pro-Ing" SH.P.K. kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i stadiumit ne Hogosht, Kamenice" me nr. të prokurimit: "KM653-23-6337-5-1-1" inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) –"Komuna e Kamenicës", me 08/04/2024, mori:

Vendim

1. **Hedhet poshtë si e palejuar**, ankesa e OE "Nika Pro-Ing" SH.P.K. me nr. 2024/0005 lidhur me vendimin e AK "Komuna e Kamenicës" lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i stadiumit ne Hogosht, Kamenice" me nr. të prokurimit: "KM653-23-6337-5-1-1", sepse konsiderohet si palë pa interes juridik material, kurse mbetet ne fuqi, njoftimi mbi vendimin e AK për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit të cituar si më sipër.

2. Lejohet kthimi i mjetevetë deponuara në emër të tarifës për sigurim të ankesës sipas paragrafit 6, të nenit 31 të Rregullores së Punës së OSHP. Kurse, ankuesi ka të drejtë që në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi, të paraqes kërkesë për kthim të mjeteve, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale --

Me 06.07.2023, Komuna e Kamenicës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Ndërtimi i stadiumit ne Hogosht, Kamenice" me nr. të prokurimit: "KM653-23-6337-5-1-1". Ndërsa me datën 15.12.2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë GOE "K.N.T.Sh. Teuta - M Sh.P.K.; N.N.P. Atc Com Sh.P.K.; N.N.Sh. World Medium":

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës punë dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 1,600,000.00 €.

Me 20.12.2023, OE) "Nika Pro-Ing" SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 22.12.2023 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 03.01.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE) "Nika Pro-Ing" SH.P.K. me nr. 05/2024 për lidhur me aktivitetin "Ndërtimi i stadiumit ne Hogosht, Kamenice" me nr. të prokurimit: "KM653-23-6337-5-1-1".

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Nika Pro-Ing" SH.P.K. *janë parashtruar si në vijim:*

Pretendimi i parë (I): "OE ankues pretendon se cilësimi i AK-së për OE si palë pa interes është i pabazuar për faktin se plotëson kërkesat e dosjes së tenderit dhe se nuk pajtohet me konstatimet e vendimit të OSHP-së 2023/0626 në lidhje me këtë çështje. AK me datë 15.12.2023 ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-së, përkatësisht letrat standarde për tenderuesit, ku në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar për OE ankues shënohet: "Me keqardhje ju informojmë se jeni eliminuar për shkak te arsyeve ne . vijim: Oferta juaj refuzohet ne pajtim me vendimin e OSHP-së i datës 03.11.2023 me numër protokolli 2023/0626". Në kërkesën për rishqyrtim të dorëzuar nga OE ankues në AK me datë 20.12.2023 nuk ka paraqitur pretendim në lidhje me eliminimin, përkatësisht arsyetimin e eliminimit të precizuar nga AK në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar. Në lidhje me këtë pretendim, eksperti sqaron se në raportin paraprak të ekspertit shqyrtues numër 2023/0626 të datës 04.09.2023 është konstatuar se krijimi i grupit-konzorciumit nuk është bërë në harmoni me LPP dhe kërkesat e parapara me dosjen e tenderit. Në vendimin e Panelit Shqyrtues të OSHP-së numër 2023/0626 në lidhje me këtë pretendim thuhet "Paneli mbështeti shpjegimet e dhëna në raportin e ekspertizës andaj pohimi ankimor në ketë rast konsiderohet i pabazuar dhe për këtë nuk mund të kërkohen informacione shtesë. Andaj OE ankues nuk ka ofertuar konform kërkesave të Dosjes së Tenderit."

Pretendimi i dytë (II) : "OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së kur ka rekomanduar për kontratë Grupi i OE-ve "K.N.T.SH. Teuta - M SH.P.K.; N.N.P. Atc Com Sh.P.K.; N.N.Sh. World Medium" (më tej GOE i rekomanduar) për faktin se i njëjti është i papërgjegjshëm për arsye se nuk ka vazhduar validitetin e ofertës ne momentin e skadimit.AK me datë 22.06.2023 ka bërë publikimin e njoftimit për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit. Hapja e ofertave është bërë me datë 02.08.2023. Në dosjen e tenderit, në Fleta e të Dhënave të Tenderit (FTD), përkatësisht tek Periudha vlefshmërisë së tenderit, neni 21.1, është përcaktuar: periudha e vlefshmërisë se tenderit do të jetë 90 ditë. Grupi i OE të rekomanduar ka dorëzuar ofertën me datë 02.08.2023 ku në formularin për dorëzimin e tenderit,

periudha e validitetit është 90 ditë nga data finale për dorëzim të tenderëve. Po ashtu është dorëzuar edhe polica e sigurimit e cila fillon me datë 02.08.2023 dhe mbaron me datë 30.11.2023. AK me datë 24.11.2023 ka publikuar dokumentin "Vazhdimi i validitetit dhe sigurimi i ofertës" drejtuar OE-ve pjesëmarrës në këtë aktivitet, ku shënohet: "Të gjithë ofertueseve të lëndës Ndërtimi i stadiumit në Hogosht, Kamenicë me nr. prokurimi KM653-23-6337-5- 1-1 kërkohet që të vazhdohet Validiteti i ofertave nga 27.11.2023 me një kohëzgjatje prej 90ditësh dhe Sigurimi i ofertës me një kohëzgjatje prej 120 ditësh. Për shkak të vonesave nga OSHP të gjitha ofertave i`u ka skaduar validetit dhe sigurimi i ofertës. Operatorët ekonomik të cilët nuk dorëzojnë Deklaratën mbi validitetin dhe nuk e vazhdojnë sigurimin e tenderit sipas kërkesës, ofertat e tyre do të shpallen si të papërgjegjshme. Këto kërkesa duhet të dorëzohen tek Autoriteti Kontraktues përmes Sistemit të E-Prokurimit deri më datë 27.11.2023 ora 16:00". Në përgjigje të kërkesës së AK-së, me datë 27.11.2023 GOE i rekomanduar ka dorëzuar konfirmimin për vazhdimin e validitetit të ofertës për 120 ditë. Gjithashtu, është dorëzuar edhe polica e sigurimit me numër të policës 120299 në të cilën shënohet se periudha e mbulueshmërisë është nga data 27.11.2023 deri me datë 26.03.2023. Neni 30.4 i RRPP përcakton "Në situata të justifikueshme dhe/ose të veçanta kur vonesa të papritura shfaqen, duke nënkuptuar që procesi i vlerësimit nuk mund të finalizohet brenda afatit të periudhës së validitetit të tenderëve për arsye të detajeve komplekse teknike të sqaruara, AK do të kërkoj nga OE të zgjasin validitetin e tenderëve të tyre. Kërkesa për zgjatje të validitetin të tenderit do të bëhet me shkrim dhe duhet të kërkohet para datës së skadimit dhe duhet të ngritët në sistem (është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit)". Në lidhje me validitetin e ofertave KRPP me datë 22.11.2022 ka dhënë interpretimin si vijon: […] Kërkesa për zgjatje të validitetin të tenderit do të bëhet me shkrim dhe duhet të kërkohet para datës së skadimit dhe duhet të ngritët në sistem (është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit)" "30.5 Në përputhje me rrethanat, nga të gjithë tenderët do të kërkohet që gjithashtu të zgjasin validitetin e sigurimit të tenderit të tyre". Sipas nenit 30.4 të lartcekur, nuk përcaktohet sa ditë para skadimit të validitetit të ofertave mund të kërkohet zgjatja e afatit të validitetit të ofertave. Megjithatë, është e rëndësishme që të ketë kontinuitet midis afatit të skaduar dhe atij të ri, për këtë arsye në këtë dispozitë thuhet: "para datës së skadimit...." Pavarësisht se aktiviteti i prokurimit është në "Pezullim", AK në përputhje me nenin 30.4 të Rregullores për Prokurimin Publik duhet që të kërkojë zgjatjen e validitetit të ofertave para datës së skadimit. Asnjë dispozitë e LPP-së dhe e legjislacionit dytësor, nuk përcakton përkufizimin e fjalës "Pezullim", megjithatë, KRPP konsideron se fjala "Pezullim" në kuptim të këtij ligji duhet të nënkuptojë mosndërmarrjen e ndonjë hapi në procedurat e prokurimit për derisa aktiviteti i prokurimit është i pezulluar. (Psh: hapja e tenderëve nuk duhet të bëhet nëse aktiviteti i prokurimit është pezulluar si rezultat i Kërkesës për rishqyrtim e parashtruar në AK, apo e një ankese e parashtruar në OSHP gjatë fazës së tenderimit, apo nënshkrimi i kontratës nuk duhet të bëhet për deri sa aktiviteti i prokurimit është në pezullim si rezultat i parashtrimit të një kërkese për rishqyrtim në AK, apo një ankese në OSHP) Neni 30.3 i Rregullores për Prokurimin Publik, kërkon rreptësishtë që oferta të ketë validitet deri te dhënia dhe nënshkrimi i kontratës. Prandaj KRPP konsideron se asnjë kontratë publike nuk mund të nënshkruhet me validitet të skaduar të ofertës. Për këtë arsye, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit duhet me kujdesin më të madh të përcjellë validitetin e ofertave, dhe në çdo rast duhet të kërkojë nga të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës zgjatjen e validitetit të ofertave para datës së skadimit. Në mënyrë retroaktive nuk mund të kërkohet zgjatja e validitetit të ofertave dhe/ose e sigurisë së tenderit. KRPP do të monitorojë me kujdes të veçantë autoritetet kontraktuese për moszbatimin e nenit 30.4 të Rregullores për Prokurimin Publik. Mos zbatimi i nenit 30.4 klasifikohet si shkelje e rëndë sipas nenit 97 të kësaj rregulloreje, andaj KRPP do të

ndërmarr masa në përputhje me nenin 97 të Rregullores për Prokurimin Publik."

Pretendimi i tretë (III) *:* "OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së pasi që ka rekomanduar GOE i cili nuk plotëson kërkesën e përshtatshmërisë të specifikuar në dosjen e tenderit, përkatësisht vërtetimet e ATK-së për dy anëtarët e grupit nuk janë valide dhe vërtetimi i Gjykatës poashtu nuk është valid.AK në dosjen e tenderit, tek kërkesat e përshtatshmërisë ka paraqitur kërkesën si vijon: "Kërkesa1.Operatori ekonomik duhet të përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit Nr. 04 L-042 042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L068 dhe Ligjin Nr. 05 L-092." Dëshmia e kërkuar dokumentare për këtë kërkesë është: "Dëshmia 1.1. Deklarata nën betim që tenderuesi i plotëson Kërkesat për të konkuruar sipas Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04 L-042, Neni 65, duke përdorur formën në Aneksin 2 të Dosjes Tenderit. Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërisë qe kërkohen nga tenderuesi qe propozohet qe te shpërblehet me kontrate dhe dorëzohen te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Dëshmia 1.2. Një vërtetim nga Administrata Tatimore e vendit Tuaj të themelimit se Operatori Ekonomik në fjalë nuk është në vonesë për pagimin e tatimeve, ky vërtetim duhet të jetë jo më i vjetër se 90 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të tenderit, duhet të dorëzohet nga OE të cilit synohet dhënia e kontratës (kopje). Dëshmia 1.3. Një dokument nga Gjykata Kompetente, që vërteton se operatori ekonomik ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit dhe se ndaj tij nuk ekziston ndonjë rrethanë e përcaktuar me Nenin 65 paragrafi 3.1, 3.3, 3.4, 3.5, 3.6, 4.1, 4.2 dhe 4.4 të LPP-së jo më i vjetër se 6 gjashtë muaj nga data e dorëzimit të tenderit, duhet të dorëzohet nga OE të cilit synohet dhënia e kontratës, të dorëzohet në Origjinal ose kopje e vërtetuar. Dështimi i Operatorit Ekonomik që është propozuar që të shpërblehet me kontratë të sjellë dokumentet e kërkuara në pikat, 1 (1.1-1.3) dhe 2 i jep të drejtë Autoritetit Kontraktues që ofertën ta refuzoj, dhe të vazhdoj me shpërblim të kontratës me Operatorin Ekonomik që është rendit ne vendin e dytë e kështu me radhë."

AK me datë 13.12.2023 përmes letër standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit ka kërkuar nga GOR i rekomanduar dokumentet si vijon: "Pasi komisioni për rivlerësimin e ofertave ju ka propozuar për fitues për lenden e lartcekur ju lutem qe te na dërgoni dokumentet e përshtatshmërisë për 3 anëtarët e grupit : 1. Një vërtetim nga Administrata Tatimore e vendit Tuaj të themelimit se Operatori Ekonomik në fjalë nuk është në vonesë për pagimin e tatimeve, ky vërtetim duhet të jetë jo më i vjetër se 90 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të tenderit, duhet të dorëzohet nga OE të cilit synohet dhënia e kontratës (kopje). 2. Një dokument nga Gjykata Kompetente, që vërteton se operatori ekonomik ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit dhe se ndaj tij nuk ekziston ndonjë rrethanë e përcaktuar me Nenin 65 paragrafi 3.1, 3.3, 3.4, 3.5, 3.6, 4.1, 4.2 dhe 4.4 të LPP-së jo më i vjetër se 6 gjashtë muaj nga data e dorëzimit të tenderit, duhet të dorëzohet nga OE të cilit synohet dhënia e kontratës, të dorëzohet në Origjinal ose kopje e vërtetuar 3. Origjinali i sigurimit te tenderit" GOE i rekomanduar me datë 14.12.2023 ka ngarkuar dokumentet si vijon: o o Vërtetimin tatimor të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës (më tej ATK), me numër serik 1001130442, i lëshuar me datë 14.12.2023, për subjektin Teuta-M Sh.P.K në të cilin shënohet "Personi është i regjistruar në ATK dhe nuk ka borxhe aktuale tatimore të pashlyera apo obligime tjera tatimore." dhe vlefshmëria " Vërtetimi vlen 90 ditë nga data e lëshimit"; o Certifikatën e lëshuar nga Gjykata Komerciale me numër 6215-23 me datë 25.10.2023 në të cilën shënohet se "ATC COM" SH.P.K nuk ka evidencë së është shpallur i falimentuar ose insolvent gjatë dy viteve të kaluara dhe se ndaj të njëjtit është iniciuar procedura e falimentimit përkatësisht likuidimit. Kjo certifikatë lëshohet në kuptim te nenit 65 paragrafi 4 nen paragrafi 4.1 dhe 4.2 i Ligjit Nr.04/L-

042 për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës. o Certifikatën e lëshuar nga Gjykata Komerciale me numër 5367-23 me datë 12.09.2023 në të cilën shënohet se N.N.SH. "World Medium" nuk ka evidencë së është shpallur i falimentuar ose insolvent gjatë dy viteve të kaluara dhe se ndaj të njëjtit është iniciuar procedura e falimentimit përkatësisht likuidimit. Kjo certifikatë lëshohet në kuptim te nenit 65 paragrafi 4 nen paragrafi 4.1 dhe 4.2 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës. o Vërtetimin Tatimor të lëshuar nga ATK, me numër serik 1001121666, i lëshuar me datë 14.11.2023, për OE Burim Zabelaj B.I. (emri tregtar N.N.SH. "World Medium") në të cilin shënohet "Personi është i regjistruar në ATK dhe aktualisht është në marrëveshje me këste për të shlyer borxhe tatimore të mbetura" dhe vlefshmëria " Vërtetimi vlen 90 ditë nga data e lëshimit". Vërtetimin Tatimor të lëshuar nga ATK, me numër serik 1001122162, i lëshuar me datë 15.11.2023, për OE N.N.P. " Atc Com " SH.P.K. në të cilin shënohet "Personi është i regjistruar në ATK dhe nuk ka borxhe aktuale tatimore të pashlyera apo obligime tjera tatimore." dhe vlefshmëria " Vërtetimi vlen 90 ditë nga data e lëshimit". o Certifikatën e lëshuar nga Gjykata Komerciale me numër 5341-23 me datë 11.09.2023 në të cilën shënohet se "ATC COM" SH.P.K nuk ka evidencë së është shpallur i falimentuar ose insolvent gjatë dy viteve të kaluara dhe se ndaj të njëjtit është iniciuar procedura e falimentimit përkatësisht likuidimit. Kjo certifikatë lëshohet në kuptim te nenit 65 paragrafi 4 nenparagrafi 4.1 dhe 4.2 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës. Eksperti sqaron se sipas provave shkresore, GOE nuk kanë dorëzuar dëshmitë lidhur me kërkesat e nenit 65 të LPP-së, paragrafit 3, nënparagrafet 3.1, 3.3, 3.4, 3.5, 3.6 sikurse është specifikuar në kërkesën e dosjes së tenderit përkatësisht dëshmitë e kërkuara."

Duke u referuar pretendimeve si më sipër "Nika Pro-Ing SH.P.K." konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 59, 60, 65 të LPP-së si dhe Neni 28 i rregullores Nr.001/2022 Për prokurim Publik. Në fund kërkojmë nga ju si OSHP që të nxjerrin: Vendim që të Aprovohet, si e bazuar ankesa e grupit të "Nika Pro-ing Sh.P.K & Pro & Co Group Sh.P.K, Anulohet, njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhe lënda te Anulohet dhe te ri-tenderohet prap ky aktivitet i prokurimit. Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi te detyruar te vazhdojmë procedurën ligjore ne institucionet tjera kompetente.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim: "Autoriteti Kontraktues Komuna e Kamenicës ka pranuar kërkesën për rishqyrtim me date 20.12.2023. Ankesa juaj nuk shqyrtohet pasi që ju nuk jeni pale me interes për AK për ketë aktivitet. Ne vendimin e OSHP-së me numër protokollit 2023/0626 ju shpalle të papërgjegjshëm. Ankesa juaj nuk vlerësohet ne pajtim me Nenin 4 paragrafi 1.25 LPP-se. Pale e interesuar - personi që mund të dëshmoje interes material nga rezultati i aktivitetit te prokurimit te zbatuar nga autoritet kontraktues ne raport me një kontrate te veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qene ose mund te jete ne rrezik te dëmtimit nga një shkelje e pretenduat. Ju nuk mund t pretendoni dëme material kur oferta juaj ishte refuzuar nga organi shqyrtues i prokurimit me vendimin 2023/0626 dhe e drejta e ankesës mund te behet ne gjykatën kompetente e jo tek AK. Gjithashtu ankesa juaj bie ne kundërshtim me nenin 108/A paragrafi 4 qe ndërlidhet me nenin 111 pika 1 paragrafi 1.8 dhe pika 4. 4. Nëse OSHP konstaton se ankesa nuk i plotëson kushtet sipas paragrafit 1. te këtij neni OSHP menjëherë do te informoje parashtruesin e ankesës me shkrim, përmes mjeteve me te shpejta të mundshme, mbi karakterin e te metat qe janë gjetur. Nëse afati për parashtrimin e ankesës ka skaduar ose skadon për me pak se katër (4) ditë, parashtruesi i ankesës do te këtë në dispozicion katër (4) ditë pas marrjes se njoftimit të tillë për të korrigjuar të metat e tilla dhe për të ri-parashtruar ankesën. Nëse afati për parashtrimin e ankesës akoma nuk ka skaduar dhe nuk skadon për me pak se dy (2) ditë, parashtruesi i kërkesës mund te ri-parashtroje kërkesën ne çdo kohe para skadimit te afatit për parashtrim. Andaj oferta juaj nuk shqyrtohet dhe nuk është e

lejuar pasi qe ju ne asnjë pike nuk mund ta vërtetoni demin material ne pajtim me te atë që është cekur me lartë."

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 12.01.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 05/2024, ndërsa me datë 15.01.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/05 me rekomandimet si në vijim:Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe aktiviteti i prokurimit. Nëse AK më tutje ka interes, aktivitetin e prokurimit ta ri-tenderojë.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK Nuk Pajtohet me rekomandimet e ekspertit shqyrtuese, ndërsa OE ka deklaruar se Pajtohet me mendimin e ekspertit.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE "Nika Pro-Ing" SH.P.K. - eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0005 ka vlerësuar si në vijim:

*Konstatimi i parë (I): "*Eksperti vlerëson se sikurse është sqaruar me sipër ky aktivitet i prokurimit ka qenë objekt i shqyrtimit në OSHP, dhe pretendimi ankimor i paraqitur në këtë ankesë është trajtuar përmes raportit paraprak të dorëzuar nga eksperti shqyrtues me datë 04.09.2023, rrjedhimisht Paneli Shqyrtues në lidhje me këtë pretendim ankimor ka vendosur në vendimin numër 2023/0626 të datës 03.11.2032. Andaj, në mbështetje të Nenit 105 të LPP-së, paragrafi 2, nën paragrafi 16, eksperti rekomandon Panelin Shqyrtues që këtë çështje ta trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata". "

Konstatimi i dytë (II) : "Eksperti fillimisht sqaron se duke marrë parasysh që afati i fundit për dorëzimin e ofertave ishte me datë 02.08.2023, në të cilën ditë edhe është bërë hapja e ofertave, afati i vlefshmërisë së tenderit të përcaktuar nga AK prej 90 ditësh përfshinë periudhën kohore 02.08.2023 deri me 30.10.2023. Rrjedhimisht, kërkesa e AK-së e bërë me datë 24.11.2023 është në kundërshtim me nenin 30.4 të RRPP ku thuhet […] kërkesa për zgjatje të validitetin të tenderit do të bëhet me shkrim dhe duhet të kërkohet para datës së skadimit dhe duhet të ngritët në sistem (është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit). Pra, AK është dashur që në pajtim me nenin e sipërpërmendur që para datës 30.10.2023 të kërkojë nga OE-të vazhdimin e vlefshmërisë së ofertave. Interpretimi i KRPP-së përcakton se është e rëndësishme që të ketë kontinuitet midis afatit të skaduar dhe atij të ri, si dhe në mënyrë retroaktive nuk mund të kërkohet zgjatja e validitetit të ofertave, andaj pretendimi ankimor në këtë pikë është i bazuar."

*Konstatimi i tretë (III): "*Eksperti sqaron se bazuar në provat shkresore në dispozicion, GOE i rekomanduar nuk ka dorëzuar të gjitha dëshmitë e kërkuara në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit, që dëshmojnë pranueshmerinë sipas nenit 65 të LPP-së. Përkatësisht, janë dorëzuar vërtetimet e ATK-së dhe certifikata nga Gjykata Komerciale në kuptim te nenit 65 paragrafi 4 nen paragrafi 4.1 dhe 4.2, por nuk janë dorëzuar dëshmitë në lidhje me nenin 65, paragrafi 3, nen paragrafi 3.1, 3.3, 3.4, 3.5 dhe 3.6. Në një rrethanë të tillë, AK ka rekomanduar për kontratë, përkatësisht ka aprovuar raportin e vlerësimit të tenderëve dhe ka publikuar njoftimin mbi vendimin dhe letrat standarde pa u siguruar se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit që lidhen me pranushmerinë e tenderuesve sipas nenit 65 të LPP-së, ashtu sikurse kërkohet me nenin 45.31 të Rregullores për prokurimin publik. Andaj, sipas sqarimeve të mësipërme pretendim ankimor i OE ankues në këtë pikë është pjesërisht i bazuar."

- *Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit te te gjithë dokumentacionit te anekses dhe procedures se prokurimit në kontekstin shpjegimeve si më sipër, ankuesin e cilëson si pale pa interes juridik material, ku nder te tjera paneli shqyrtues vuri në zbatim nenin 103 të LPP, sipas të cilit, "Dispozitat e kësaj pjese përcaktojnë të drejtat themelore dhe procedurale dhe mjetet juridike në dispozicion të palëve të interesuara siç është përkufizuar ky term ("palë e interesuar") në nenin 4 te këtij ligji". Kuptimi i kësaj dispozite vërteton fare qartë mendimin e këtij Paneli se, mjetet juridike mund të vihen në lëvizje vetëm nga palët e interesuara duke ju referuar ne ketë rast pikërisht përkufizimit të dhënë në nenin 4, të LPP.

Prandaj bazuar në kuptimin e nenit 4, të LPP, lidhur me nenin 103 dhe 111, të këtij Ligji, Paneli konsideron se parashtruesi i saj nuk mund të konsiderohet palë e interesuar dhe se nuk ka nevojë të lëshohet në vlerësimin meritor të pohimeve specifike të kësaj Ankese, sepse të njëjtat janë jo lëndore në kuptim të neni 111, të LPP dhe per këtë çështje juridike është dhënë një vendim me nr. 2023/0626, nga paneli shqyrtues ku është konstatuar se ankuesi në këtë rast "“Nika Pro-Ing” SH.P.K", nuk ka ofertuar konform kërkesave të Dosje së Tenderit që d.t.th është kualifikuar si OE i papërgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit. Paneli Shqyrtues konsideron se lidhur me këtë aktivitet te prokurimit është nxjerrë një vendim paraprakme nr. 2023/0626, ku OE ankues nuk ka arritur te dëshmoj, bind Panelin Shqyrtues se i njëjti është tenderues i përgjegjshëm, sikurse parashihet me nenin 60 të LPP-së, andaj mbi bazën e te lartcekurave, konsiderohet si palë pa interes juridik material, konform nenit 4 paragrafi 1.26 të LPP-së, lidhur me ankesën Nr. 2024/0005. Paneli shqyrtues konstatimet e tij i bazon kryesisht në dispozite relevantet e LPP-së, te cilat parashohin dhe rregullojnë situatat e tilla, te cilat mund te paraqiten gjatë një aktiviteti te prokurimit sikurse ankesa nga grupi i OE ne këtë rast.

Pas analizimit të shkresave të lartpërmendura të cilat i kishte në dispozicion Paneli Shqyrtues, si: Ankesat e OE ankues, raportet e ekspertit shqyrtues, vendimin nr.2023/0626, dihet mirë se vendimet e OSHP-së janë të detyrueshme për autoritetet kontraktuese dhe të gjitha palët në procedurë, dhe se kundër vendimeve të OSHP-së, palët mund të ankohen në gjykatën kompetente brenda afatit ligjor me mjete të rregullta juridike, në përputhje me këshillën juridike të dhënë në vendim.

Andaj, Paneli shqyrtues vendos ti jep të drejtë AK dhe që ta lë në fuqi vendimin e AK, vendim ky i cili është nxjerrë nga një komision i vlerësimit i cili supozohet të jetë profesional dhe po ashtu përgjegjës sipas nenit 59.1 cituar Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës, rrjedhimisht pasi që Paneli

shqyrtues ka konstatuar ashtu sikurse AK, se ankuesi është i papërgjegjshëm (eleminuar). Andaj edhe për Panelin Shqyrtues sikurse edhe nga Eksperti shqyrtues, ankuesi në këtë rast kualifikohet si pale pa interes interes juridiko-material sipas nenit 4.1.26 të LPP, ngase të njëjtit në asnjë rethanë nuk mund të jetë fitues potencial mbi bazën e ofertës tyre të kësaj kontrate publike.

Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht ne pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar ”Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj”.

Këtë vendim Paneli shqyrtues e mbështet edhe tek neni 31, paragrafi 2 i Rregullores së Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit nr.83/20. Prandaj bazuar në kuptimin e nenit 4, të LPP, lidhur me nenin 103 dhe 111, të këtij Ligji, Paneli konsideron se parashtruesi i saj nuk mund të konsiderohet palë e interesuar dhe se nuk ka nevojë të lëshohet në vlerësimin meritor të pohimeve specifike të kësaj Ankese, sepse të njëjtat janë jo lëndore në kuptim të neni 111, të LPP. Ndërsa, autoriteti kontraktues mbanë përgjegjësi të plotë sa i përket respektimit të dispozitave ligjore për prokurimit publik., konform nenit 24, paragrafit 2 të LPP, si dhe dispozitave tjera ligjore.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit te te gjithë dokumentacionit te anekses dhe procedures se prokurimit në kontekstin shpjegimeve si më sipër, ankuesin e cilëson si pale pa interes juridik material, ku nder te tjera paneli shqyrtues vuri në zbatim nenin 103 të LPP, sipas të cilit, “Dispozitat e kësaj pjese përcaktojnë të drejtat themelore dhe procedurale dhe mjetet juridike në dispozicion të palëve të interesuara siç është përkufizuar ky term (“palë e interesuar”) në nenin 4 te këtij ligji”. Kuptimi i kësaj dispozite vërteton fare qartë mendimin e këtij Paneli se, mjetet juridike mund të vihen në lëvizje vetëm nga palët e interesuara duke ju referuar ne ketë rast pikërisht përkufizimit të dhënë në nenin 4, të LPP.

Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Paneli shqyrtues në këtë vendim marrje ka pasur ne konsideratë edhe kërkesat e nenit 104, paragrafi 4 të LPP, sipas të OSHP duhet të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KOMUNA E KAMENICËS**
- OE - **NIKA PrO- Ing SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: